



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/2023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 27.01.2026, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me numër të referencës: LMJBAO-0170, lidhur me pretendimet e ngritura nga raportuesi i rastit për konflikt të interesit përkitazi me punësimin e L.I, sipas konkursit të shpallura nga Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” SH.A - Mitrovicë, për pozitën “Roje”, datë. 30.01.2025 nr.prot.24, për shkak se në rastin konkret nuk është konstatuar situatë e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit.
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në ueb faqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

## A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, respektivisht dyshimeve për përfshirjen në vendimmarrje për zyrtaren B.I.-S, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga një raportues anonim (në vijim: raportuesi i rastit), me pretendimet se (citojmë nga kërkesa): “[...]është punësuar babi i asistentes së U.D. Kryeshefit Ekzekutiv në pozitën e rojtarit në po të njëjtën kompani. Emri i asistentes është B.I.S ndërsa i punësuarit si rojtar konkretisht babai i saj quhet L .I. Skandali thellohet edhe me shume se ky person është punësuar si roje në moshën 63 vjeçare ku i bie që menjëherë pas dy viteve të del në pension. [...]”.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke ndërmarrë veprimet e nevojshme verifikuese lidhur me pretendimet e raportuesit të rastit, për dyshime që mund të lidhen me situatë të konfliktit të interesit, përfshirë të dhënat relevante, duke përfshirë dosjen e konkursit publik të datës 01.02.2025 nr. referencës 30-01-2, e cila dosje përfshin dokumentet si në vijim:

- 1.Kërkesën për iniciimin e shpalljes se konkursit date 28.01.2025 me nr.prot.19,
- 2.Vendimin për Shpalljen e konkursit për pozitë Roje-Mitrovicë dt.30.01.2025 nr.prot.24,
- 3.Konkursi i dt.01.02.2025 Roje Mitrovicë,
- 4.Vendimin për zgjedhjen e komisionit për mardhënje pune për pozitën Roje-datë nr.prot.127,
- 5.Vendimin për zgjedhjen e komisionit të përkohshëm për ankesa për konkursin 01.02.2025,
- 6.Verifikimi paraprak i dokumentacioneve të kandidatëve dt.20.02.2025 me nr.prot.222,
- 7.Njoftimi për kandidatet të cilët i plotësojnë kriteret sipas konkursit dt.20.01.2025 me nr. prot 222.
- 8.Njoftimi për testimin me shkrim dt.24.02.2025 nr.prot.229,
- 9.Lista e kandidatëve me piket e arritura në testin me shkrim, dt.04.02.2025 me nr.prot.267,
- 10.Njoftimi dt.04.03.2025 me nr.prot.267,11. Lista përfundimtare e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për t'ju nënshtruar intervistës për pozitën roje në Mitrovicë, dt.07.03.2025 me nr.prot.291,
- 12.Lista e kandidatëve me piket e arritura në intervistë dt.14.03.2025 me nr.prot.323,
- 13.Lista e kandidatëve me piket e arritura në testim me shkrim dhe intervistë dt.14.03.2025 me nr.prot.323, 14.Raport përfundimtar dt.14.03.2025 me nr.prot.324 .

Nga verifikimet e kryera, dhe administrimi i provave në dispozicion Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas zhvillimit të procedurës, ka konstatuar se dyshimet e ngritura për situatë të mundshme të konfliktit të interesit në rastin konkret nuk kanë rezultuar me rrethana të një situate të konfliktit të interesit, pasi që është vërtetuar se në procesin në fjalë nuk ka rezultuar që ka pas ndonjë vendimmarrje apo veprim paraprak në të cilin ka marr pjesë personi i afërt me zyrtarin e punësuar sipas konkursit të shpallur nga Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A. Mitrovicë, për pozitën Roje, me dt.30.01.2025 nr.prot.24.

Kështu që, në rastin konkret, Agjencia ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë me ndonjë rrethanë të situatës me konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Sipas dispozitave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, në neni 6 të tij, është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ku shprehimisht thuhet:

*"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare".*

Po ashtu, me nenin 3 [Përkufizimet], paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, është përkufizuar se:

*"Interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste", nën paragrafin 1.6 të këtij neni me të cilin është përkufizuar se:*

*"person i afërm me zyrtarin është bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët interesi privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin. Për qëllime të këtij ligji, personi juridik konsiderohet si person i afërm, sipas dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës".* Ndërsa, nën paragrafi 1.12 i këtij neni

përcakton vendimmarrjen si: "çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."

Pra, në kuptim të dispozitave të sipërcituara, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes, nën kushtet e ekzistencës së interesit privat të zyrtarit/ve apo të personave të afërm me ta, në një çështje të caktuar.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, këtë rast e ka trajtuar vetëm në kontekst të konfliktit të interesit të bazuar në dispozita të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrim të funksionit Publik, dhe nuk ka trajtuar çështje tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit e të cilat nuk janë brenda mandatit të Agjencisë.

**II.** Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, me të cilin është përcaktuar se: "Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative."

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik (subjekt i trajtimit për konflikt të interesit)
- Palës raportuese
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrtarit përgjegjës

  
Yll Buleshkaj  
Drejtor i Agjencisë  
për Parandalimin e Korrupsionit